



POLITIKA E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË

ASHNA është e përkushtuar të ruaj dhe rris sigurinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e shërbimeve të navigimit ajror, që përmbushin ose tejkalojnë nevojat dhe pritjet e klientëve tanë, duke respektuar të gjitha kërkesat e aplikueshme ligjore.

Është politikë e ASHNA-s të krijoj, zbatoj dhe mirëmbajë një sistem për menaxhim të cilësisë brenda organizatës, përmes së cilës sigurohet realizimi i plotë i detyrave tona, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të sigurta, efikase dhe cilësore të navigimit ajror në Republikën e Kosovës.

Shfrytëzuesit e shërbimeve tona janë shumë të rëndësishëm për ne, prandaj përpiqemi që të ofrojmë shërbime sa më cilësore, duke matur kënaqshmërinë e shfrytëzuesve të shërbimeve tona, duke përmirësuar vazhdimisht efektivitetin dhe efikasitetin e punës sonë, duke monitoruar performansën tonë kundrejt objektivave të vendosura dhe duke promovuar përfshirjen e personelit në të gjitha proceset e punës.

Për të arritur këtë, ne jemi të përkushtuar si në vijim:

1. Siguria është Primare: Prioritizimi i sigurisë mbi të gjitha në operimet tona, duke siguruar standardet më të larta të sigurisë për menaxhimin e trafikut ajror, pajisjet e navigimit dhe sistemet e komunikimit.

2. Përmirësimi i Vazhdueshëm: Përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve, sistemeve dhe shërbimeve tona përmes monitorimit të rregullt, vlerësimit dhe mekanizmave të rregullt për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin.

3. Kënaqësia e Klientit: Kuptimi dhe përmbushja e nevojave aktuale dhe të ardhshme të klientëve tanë duke ofruar shërbime që janë të besueshme, të përgjegjshme dhe të cilësisë së lartë.

4. Përputhshmëria: Sigurimi i përputhshmërisë me të gjitha kërkesat ligjore, rregullative dhe kërkesave të industrisë, si dhe duke i'u përmbajtur standardeve të njohura ndërkombëtare, përfshirë ISO 9001:2015.

5. Kompetenca dhe Trajnimet: Investimi në zhvillimin dhe trajnimin e personelit tonë për të mbajtur nivele të larta të kompetencës, profesionalizmit dhe aftësisë/zotësisë në rolet e tyre të veçanta.

6. Menaxhimi i Rrezikut: Identifikimi, vlerësimi dhe zbutja e rreziqeve të lidhura me operimet tona për të zvogëluar ndërprerjet dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e shërbimeve tona.

7. Përgjegjësia Mjedisore: Zvogëlimi i ndikimit negati mjedisor nga operimet tona duke adoptuar praktika dhe teknologji të qëndrueshme kur është e mundur.

8. Sjellja Etike: Mbajtja e standardeve më të larta të integritetit, transparencës dhe sjelljes etike në të gjitha ndërveprimet tona me klientët, palët e interesit dhe komunitetin.

9. Partneriteti dhe Bashkëpunimi: Nxitja e partneritetit dhe bashkëpunimit me palët e interesit, duke përfshirë autoritetet e aviacionit, operatorët ajror dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve, për të promovuar ndërveprueshmërinë dhe për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të sistemit të navigimit ajror.

Politika e cilësisë është komunikuar, kuptuar dhe zbatohet në të gjitha nivelet e organizatës. Për të siguruar vazhdimësinë dhe efektivitetin e saj, kjo politikë rishikohet rregullisht.

10. Vendimmarrja Bazuar në të Dhëna: Përdorimi i të dhënave dhe analizave për të informuar proceset e vendimmarrjes, optimizimin e alokimit të burimeve dhe për të shtyrë iniciativat e përmirësimit të vazhdueshëm.

Është obligim i menaxhmentit dhe i secilit zyrtar në ASHNA që të zbatoj legjislacionin në fuqi dhe procedurat e dokumentuara të punës të përshkruara në Manualin për Menaxhimin e Cilësisë si dhe manualet dhe dokumentet tjera të ndërlidhura.

Jemi të përkushtuar për të arritur këto objektiva dhe për të përmirësuar vazhdimisht efektivitetin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në ASHNA.

Menaxhmenti i ASHNA siguron që Politika e SMC është:

- Është në harmoni me qëllimin e ndërmarrjes;
- Përfshinë përkushtimin dhe angazhimin për të përmbushur kërkesat dhe për të përmirësuar vazhdimisht efektivitetin e sistemit të menaxhimit të integruar dhe vazhdimisht modifikuar atë sipas rregulloreve dhe përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare;
- Ofron bazë për vendosjen dhe rishikimin e objektivave të SMC;
- Është komunikuar vazhdimisht me menaxhmentin dhe është e kuptuar brenda ndërmarrjes,
- Është rishikuar për përshtatshmërinë ndaj përmirësimit të vazhdueshëm.

ISO Ekipi është përgjegjës për të siguruar që politika e sistemit të integruar të menaxhimit është rishikuar gjatë procesit të rishikimit të menaxhimit.

Aprovuar nga Drejtori: